



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Datozuar Primjenos / Predato Received / Delivered	02.09.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shfaqje Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSACK	5125/2022		115



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.651/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, më Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.651/2022 të datës 27.07.2022 të parashtruar nga ankuesi nga Prishtina, me adresë banimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 02.09.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

*Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.651/2022 e datës 25.07.2022 e parashtruar nga ankuesi*

**A r s y e t i m**

Ankuesi më datë 22.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4272/2022, e plotësuar me datë 11.08.2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të datës 15.07.2022, lidhur me mos përfshirjen në listën e kandidatëve fitues për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, me bazë ankimore që të anulohet njoftimi i datës 15.07.2022 dhe të obligohet Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë që ankuesit ti mundësohet ri testimi me gojë me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të paanshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Ndërsa Këshilli më datë 02.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër A.nr.651/2022 e datës 25.07.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur*

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për qasje në dokumente zyrtare të datës 20.07.2022 të ankuesit; e-mailin e datës 15.07.2022 nga [simbni@rks-gov.net](mailto:simbni@rks-gov.net) për ankuesin; Njoftimin e datës 15.07.2022 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publike për kandidatët fitues; Njoftimin e datës 13.07.2022 nga [simbni@rks-gov.net](mailto:simbni@rks-gov.net) për ankuesin; Njoftimin e datës 04.07.2022 nga [redacted] për ankuesin; Njoftimin e datës 14.06.2022 për kandidatët e përfshirë në listën e ngushtë nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Konkursin me numë rreference RN00008914 të datës 28.04.2022; e-mailin e datës 21.07.2022 nga ankuesi për [redacted] Plotësim ankese nga ankues e darës 11.08.2022; Emailin e datës 22.07.2022 nga ankuesi për [redacted] Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 27.07.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 02.08.2022; Vendimin me Nr.04/73 i datës 30.04.2022 për emërimin e Komisionit Shtetëror të Pranimit; Lista e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar; e-mailin e datës 15.06.2022 nga [redacted] për ankuesin e-mailin e datës 15.07.2022 nga [redacted] për ankuesin; Listën e renditjes përfundimtare të kandidatëve e datës 15.07.2022; Udhëzimin për kandidatët për emërimin në pozita të nivelit të lartë; Aplikacionin e ankuesit se bashku me dokumentet e bashkangjitura si Diplomën me Nr.5984 e datës 18.11.1987; Certifikatën e trajnimit " Human Rights Protection in Democratic Justice Systems" për përudhën 15-26.04.2002; Certifikatën e trajnimit " Articles 5 and 6 of the European Convention on human Rights and Practical Aspects of Taking Cases to the European Court of Human Rights" për periudhën 27-28.05.2002; Certifikatën e trajnimit " Mediator's Code of Conduct and Supervised Session conducted by the System for Enforcing Agreements and decisions (SEAD) Program" korrik 2011; Certifikatë ' Business Valuation" për periudhë 12-12.07.2011; Certifikatën e trajnimit "Shkrimi dhe arsyetimi juridik në gjuhën e thjeshtë" për periudhë 11.11-06.12.2002; Letër referencë e datës 28.01.2003; Certifikatën e Regjistrimit të biznesit me nr. serik 10038600 e datës 01.07.2019; Shkresë për Informata mbi biznesin e datës 01.07.2019; Vërtetimin Vr. Nr. 597/2022 të datës 02.06.2022; Letër motivimi nga ankuesi; Certifikatën e Gjykatës Themelore në Prishtinë Pn.nr.11088/2022 e datës 01.06.2022; Vërtetimin me Nr. 386 i datës 03.06.2022; Vërtetimin me Nr.Port:154/2017 i datës 12.10.2017; Vendimin për emërimin e Sekretari të Këshillit Komunal në Gjilan me Nr. Prot:01-397/99 i datës 30.12.1999; Licencë për Ndërmjetësues e datës 26.09.2011; Deklaratën personale të ankuesit e datës 03.06.2022; Aplikacionin e kandidatit se bashku me dokumentacionin e bashkangjitur: Diplomën e datës 20.12.2008, Vendimin me Nr. Ref:6-2238 të datës 26.04.2018 të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Diplomën me Nr. 828 e datës 01.09.2004, Vërtetimin për marrëdhënie pune i datës 02.06.2022, Certifikatën për periudhën 27.04-02.07.2009, Certifikatën e trajnimit e datës 25.09.2009, Certifikatën e trajnimit Janar 2011, Certifikatën e trajnimit për periudhë 07-11.09.2015, Certifikatën e trajnimit për periudhën 03-07.07.2017, Certifikatën e Trajnerit/IKAP e datës 20.12.2017, Certifikatën e trajnimit e datës 17.03.2005, Certifikatën e trajnimit për periudhën 28-29.09.2006, Certifikatën e trajnimit e datës 14.04.2004, Certifikatën e trajnimit 02.12.2003, Certifikatën e trajnimit e datës 20.05.2004, Certifikatën e trajnimit e datës 25.06.2004, Certifikatën e trajnimit e datës 09.06.2004, Certifikatën e trajnimit e datës 18.06.2004, Certifikatën e trajnimit e datës 20-22.09.2017, Certifikatën e trajnimit e datës 30.06.2004, Certifikatën e trajnimit e datës 27.10.2004, Certifikatën e trajnimit e datës 29.04.2004, Shkresën e datës 11.02.2008, Kontratën për Punësim për kohë të caktuar e datës 01.06.2007, Kontratën e Punësimit e datës 24.02.2010, Akt Emërimi i datës 01.11.2011, Vendimin e datës 01.11.2011, Vendimin me Nr.158/2011 i datës 30.11.2011, Certifikatën e trajnimit e datës 01.07.2003, Certifikatën e trajnimit e datës 17.12.2004, Letër Rekomandimin i datës 13.12.2004, Shkresë e datës 06.11.2007, Letër Rekomandimin e datës 11.02.2014, Shkresën e datës 29.06.2007, Referencë e datës 06.06.2014, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 21.12.2021, 23.11.2020, Letër motivuese nga [redacted] e datës 03.06.2022, Certifikatën Shëndetësore e datës 02.06.2022, Certifikatën PNDP.nr. 1597/22 e datës 27.05.2022, Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Viti e datës 26.05.2022, Vendimin me Nr. 292/2013 i

datës 24.12.2013; Aplikacionin e kandidatit [redacted] se bashku me dokumentacionin percjelles; Diplomën e datës 09.10.2008, Vendimin me Nr.Ref:6-3007 të datës 11.07.2018 të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Diplomën me Nr.418 e datës 18.07.2007, Certifikatën e trajnimit e datës për periudhën 03-05.07.2017, Certifikatën e trajnimit e datës 13.04.2016, Certifikatën e trajnimit e datës 30.06.2014, Certifikatën e trajnimit e datës tetor 2013, Certifikatën e trajnimit e datës 10-14.09.2012, Certifikatën e trajnimit e datës 12.07.2012, Certifikatën e trajnimit e datës për periudhën 18-20.04.2011, Certifikatën e trajnimit e datës 25.09.2009, Certifikatën e trajnimit e datës 19.05.2009, Certifikatën e trajnimit e datës 18.09.2008, Kontratën e marrëdhënies së punës e datës 01.10.2008, Vendimin me Nr.445/2010 i datës 13.07.2010, Vendimin e datës 24.11.2011, Vendimin me Nr.168/1/2012 i datës 31.01.2012, Vendimin me Nr. 179-1/2012 i datës 01.02.2012, Akt Emërimit e datës 06.11.2012, Vendimin e datës 01.06.2020, Vërtetimin e datës 01.06.2022, Letër rekomandim për [redacted] nga [redacted] Letër Rekomandimin nga [redacted] Vërtetimin me Nr. Ref: 46/2022 i datës 01.06.2022, Letër motivimi; Vërtetimin e datës 26.05.2022, Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë e datës 20.05.2022, Certifikatën Shëndetësore e datës 06.06.2021; Aplikacionin e kandidatit [redacted] se bashku me dokumentacionin e bashkangjitur: Diplomën me Nr.2470 të datës 04.12.2020, Diplomën me Nr.95 të datës 18.01.2007, Certifikatën Shëndetësore, Vërtetimin me Nr.121/2022 i datës 30.05.2022, Vendimin me Nr. 094/2021 i datës 16.06.2021, Autorizim me numër Ref:088/2020 i datës 24.07.2020, Autorizimin me numër Ref:143/2018 i datës 24.08.2018, Autorizimin me numër Ref: 126/2017 i datës 16.08.2017, Autorizimin me numër Ref:090/2017 i datës 05.06.2017, Autorizimin me numër Ref:75/2016 i datës 22.06.2016, Autorizimin me numër Ref:007/2016 i datës 03.02.2016, Autorizimin me numër ref:149/2015 i datës 31.07.2015, Autorizimin me numër Ref:098/2016 i datës 19.08.2016, Konfirmimin me Nr. Prot:122/2022 i datës 30.05.2022, Letër motivimi nga A.Krasniqi, Vendimin me Nr.06/36 i datës 22.09.2021, Vendimin me Nr.03/77 i datës 10.08.2009, Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë e datës 31.05.2022, CV-në e kandidatit [redacted] Certifikatën për [redacted] CV-në, Certificate (pa numer dhe date, Certifikatën e trajnimit e datës për periudhën 09-13.07.2007, Certifikatën e trajnimit e datës 14.11.2006, Certifikatën e trajnimit e datës për periudhën dhjetor 2006 deri gusht 2007, Certifikatën e trajnimit e datës për periudhën 17-18.05.2007, Certifikatën nga RESPA 30.09-02.10.2013, Certifikatën e trajnimit e datës 29.05.2008, Korikula e Programit Shkollor, Certifikatën e trajnimit e datës 23.12.2021, Shkresën- sepcific agreement e datës 15.12.2015, Dekretin Nr.DMN-009/2017 e datës 14.12.2017, shtojce, Kërkesë për prova e datës 17.08.2022; Përgjigjen në kërkesë e datës 17.08.2022; Konkursin për praninë të mbyllur me Nr. Referencës RN00007560 i datës 30.08.2021 për pozitën Sekretar i Përgjithshëm 1 për Zyrën e Kryeministrit; Lista e aplikantëve me kandidatë të aprovuar; Njoftimin e datës 19.10.2021 lidhur me listën e ngushtë të kandidatëve; Vendimin me Nr. 07/2021 të datës 10.11.2021 për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve; Njoftimin e datës 12.11.2021 për kandidatët fitues; Vendimin me numër protokollit 1596 të datës 02.12.2021 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme për përfundimin e procedurës së rekrutimit për pozitën Sekretar i Përgjithshëm 1 për Zyrën e Kryeministrit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi *së është e pa bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së Njësia Përgjegjëse përkatësisht Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 28.04.2022 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00008914 për pozitën *Sekretar i Përgjithshëm 1* në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, i hapur për aplikim nga data 28.05.2022 deri më datë 04.06.2022. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, dhe është njoftuar më datë 15.06.2022 nga Departamenti për

Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë së i njëjti ka plotësuar kushtet e konkursit dhe se do të vazhdoj më procedurat e mëtejme të rekrutimit.

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë më datë 15.07.2022 ka publikuar njoftimin me kandidatët fitues, me ç'rast ankuesi nuk është propozuar si një nga tre kandidatët fitues.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se në këtë proces ka pasur shkelje juridike materiale dhe procedurale duke shtuar se nuk është njoftuar se cilat kanë qenë arsyet e mos përfshirjes në listën fituese, nga Komisioni i Pranimit nuk është njoftuar lidhur strukturën e intervistës, gjegjësisht me kohëzgjatjen e intervistës, numrin e pyetjeve dhe mënyrën e vlerësimit. Me tutje ankuesi shton se i njëjti është diskriminuar në krahasim me kandidatët e tjerë për faktin pretendon që një nga kandidatët nga lista fituese ka pasur më pak pikë në testin me shkrim në krahasim me pikët që ka marrë ankuesi.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave materiale ka gjetur se sipas Konkursit me numër reference RN00008914 për pozitën Sekretar i Përgjithshëm 1 në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: *Diplomë universitare me të paktën 240 kredi/ECTS-së apo ekuivalente, preferohet në fushat që lidhen me fushëveprimin e institucionit ku rekrutohet siç janë: drejtësia, menaxhimi, shkencat politike, administrata publike dhe të ngjashme.., Së paku (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë punë në pozita drejtuese.*

Më qëllim të vendosjes së drejtë dhe të ligjshme lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 86 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka shqyrtuar në tërësi ligjshmërinë procedurale dhe materiale të procedurës së rekrutimit ndërlidhur me pretendimet ankimore për pozitën *Sekretar i Përgjithshëm 1* në Zyrën e Kryeministrit dhe rrjedhimisht ka konstatuar se verifikimi paraprak i kandidatëve është bërë në pajtim me nenin 8 të Rregullores (QRK) Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, ndërsa lidhur me procedurën e vlerësimit-testimit me shkrim dhe intervistës më gojë, bazuar në provat material të çështjes, nuk është konstatuar tejkalim i dispozitave procedurale dhe materiale.

Lidhur me pretendimin ankimor se ankuesi nuk është njoftuar lidhur me arsyet e mos përfshirjen në listën fituese, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se më datë 15.07.2022 ankuesi është njoftuar përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore se janë publikuar rezultatet përfundimtare të kandidatëve, po ashtu i njëjti më datë 15.07.2022 është njoftuar përmes emailit nga njësia përgjegjëse për pikët e testit me shkrim intervistës me gojë dhe me pikët e përgjithshme, andaj mbi këto fakte rrjedhë se pretendimet e ankuesit në këtë kuptim janë të pabazuara, përkatësisht ankuesi është njoftuar në pajtim me dispozitat e nenit 13 paragrafi 18 dhe 19 të Rregullores (QRK) Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues ku shprehimisht theksohet se:... *Lista e kandidatëve si në paragrafin 15 të këtij neni publikohet në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit për nëpunësit civilë dhe ueb faqen e institucionit. 19. Kandidatët që nuk janë fitues njoftohen personalisht nga njësia përgjegjëse dhe kanë të drejtën e ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, brenda afatit prej tetë (8) ditëve kalendarike pas pranimit të njoftimit.*

Përkitazi me pretendimin ankimor të ankuesit se i njëjti është diskriminuar në krahasim me kandidatët e tjerë, për faktin se një nga kandidatët nga lista fituese ka pasur më pak pikë në testin me shkrim në krahasim me pikët që ka marrë ankuesi, Kolegji nga vlerësimi i provave materiale ka gjetur se ankuesi në testin me shkrim ka arritë 34.73 pikë, ndërsa në intervistë me gojë është vlerësuar me gjithsejtë 22.16

pikë, pra totali i pikëve të përmbledhura është 56.89 pikë, dhe me asnjë provë nuk është provuar se Komisioni i Pranimit ka bërë vlerësime jo të drejt të ankuesit me rastin e intervistës më gojë, dhe rrjedhimisht nuk ka gjetur rrethana të diskriminimit të ankuesit në raport me kandidatet e tjerë, andaj Kolegji vlerëson së Komisioni i Pranimit ka vepruar në pajtim me nenin 13 paragrafi 16 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues ku është përcaktuar se: *Jo më shumë se tre (3) kandidatë dhe jo më pak se dy (2) kandidatë të vlerësuar nga komisioni i pranimit, me pikët më të larta dhe mbi pragun minimal të 70 e më shumë për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohen kandidatë fitues dhe bashkë me poentimet e tyre, propozohen, për përzgjedhje përfundimtare nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Në rast të pikëve të barabarta zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e nenit 27 të Rregullores përkatëse për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.*

Bazuar në gjendjen faktike dhe bazën juridike të vërtetuar si me lartë, Kolegji konstaton se procedura e rekrutimit lidhur me pozitën Sekretar i Përgjithshëm 1 në Zyrën e Kryeministrit është zhvilluar në pajtim me nenin 6 dhe 40 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, andaj duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

#### **Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

### **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda me numër A.nr.651/2022

**Avdyll BEKTESHI**

*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*Kryetare e Kolegjit*



#### **Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesi,
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

